



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I TIRANËS  
FAKULTETI I HISTORISË DHE I FILOLOGJISË  
DEPARTAMENTI I GAZETARISË DHE KOMUNIKIMIT



Programi: **Bachelor**

Drejtimi: **Gazetari**

**Lënda: MENDIMI POLITIK EVROPIAN I SHEK. XVII - XVIII**

<i>Pedagogu:</i>	Juliana Marko
<i>Ngarkesa:</i>	3 ETCS (15 javë: 2 leksione në javë)
<i>Lloji i lëndës:</i>	e detyrueshme
<i>Viti/semestri:</i>	II/II

**Përshkrimi:** Mendimi Politik i shek. XVII – XVIII, synon t’i pajisë studentët e Gazetarisë dhe Komunikimit me njohuri historike dhe teorike në lidhje me mendimin politik të një periudhë mjaft të rëndësishme për formësimin e platformave ideore politike. Do të parashtrihen jo vetëm sfondi historik i kohës dhe veprat kryesore të studiuesve klasikë, por edhe ndikimi i tyre në jetën politike e sistemet e qeverisjes në epokën bashkëkohore.

**Temat e leksioneve:**

1. Sistemet politike në kontekstin e strukturave bashkohore  
Politika  
Ideologjia
2. Tipat që përdoren në ushtrimin e qeverisjes  
Funksionet e qeverisjes  
Kultura politike
3. Pikënisja ideore e J. Locke për “Traktat i dytë i qeverisë civile: Ese për origjinën e vërtetë, zhvillimin dhe fundin e shoqërisë civile” ;  
Karakteristikat sipas e gjendjes natyrore të njeriut para lidhjes së kontratës shoqërore
4. Të drejtat natyrore të njeriut, pse konsiderohen të patjetërsueshme;  
Koncepti i Locke në lidhje me dallimin midis pushteteve;  
E drejta e rezistences, impakti i saj në legjislacionin bashkëkohor.
5. Teoria e Montesquieu në lidhje me ligjet dhe raportet që ato kanë me a) mbrojtjen e shtetit; b) lirinë dhe sigurinë; c) mjetet e qeverisjes.  
Teoria e Klimave dhe shkaqeve fizike mbi ligjet në veprën e Montesquieu ;  
Republika demokratike sipas Montesquieu, karakteristikat kryesore të këtij lloji qeverisjeje dhe mekanizmat në bazë të të cilave vepron.
6. Monarkia, karakteristikat kryesore të këtij lloji qeverisjeje dhe mekanizmat në bazë të të cilave vepron.
7. Despotizmi sipas Montesquieu, karakteristikat kryesore të këtij lloji qeverisjeje dhe mekanizmat në bazë të të cilave vepron.  
Liria politike, realizimin e lirisë politike në modelin britanik ;  
Teoria e ndarjes së pushteteve, argumentimi i domosdoshmërisë së saj.

8. Koncepti i sovranitetit dhe vullnetit të përgjithshëm sipas Rousseau: Kontrata sociale. Roli i ligjit në marrëdhënie me vullnetin e njeriut, diskutimi mbi formën më të përshtatshme të qeverisjes.  
Format e qeverisjes, karakteristikat dhe gjykimi për to sipas J.J. Rousseau.
9. Pikënisja e shkrimit të “Rendi i Tretë” dhe ndikimi i vepres së Sieyes në Revolucionin francez. Karakteristikat sociale të Rendit të Tretë, aktualiteti i tij (sipas Sieyes) dhe propozimi për rolin shoqëror e politik në të ardhmen.
10. Pikënisja dhe frymëzimi historik për shkrimin e “Shënime për Revolucionin Francez” të E. Burke. Kritika ndaj Revolucionit dhe institucioneve të reja të lindura prej tij ;
11. Gjykimi negativ në përgjithësi mbi konceptin e abstraktes perballë natyrës dhe harmonisë.
12. Karakteristikat kryesore të nacionalizmit modern, krahasim me nacionalizmin e skajshëm të shek.XX.  
Tema kryesore e “Fjalime kombit gjerman”, cila është risia dhe platforma e Fichte?
13. Karakteristikat komponentit psikologjiko-kulturor të nacionalizmit.  
Karakteristikat e komponentit konstitucional-institucional të nacionalizmit.
14. Historiku i levizjes komuniste e socialiste prej Saint Simon te “Manifesti”.  
Materializmi dialektik dhe materializmi historik si filozofi e përgjithshme.
15. Mekanizmat funksionale të luftës së klasave dhe vlerësimi historik mbi të sipas Marx.  
Diktatura e proletariatit dhe ideja e shoqërisë pa klasa.

#### **Forma e kontrollit dhe vlerësimit**

- Detyrim frekuentimi në: 70% të seminareve	
- Angazhimi në seminare:	10% e notës
- Detyra e kursit ose ese: rreth 5 faqe format A4, TNR, 12, hapësira 1.5):	20% e notës
- Kontrolli përfundimtar: provim me shkrim	70% e notës
- Gjithsej:	100%

#### **Literatura e detyrueshme për studentin:**

- J.J Chevalier/Y.Guchet: *Veprat e mëdha Politike - Nga Makiaveli deri në ditët tona*. Tiranë, Lira, 2006
- Zherard Mere: *Kryeveprat e mendimit politik. Hyrje në Teorinë e Politikës*, Tiranë, Botimet Dita 2000 , 2007
- M. Schmidt, *Teoritë e Demokracisë*, Tiranë, Botart 2012
- A. Heiud, *Politika*, Tiranw, Dudaj, 2009
- John Gray, *Liberalizmi* (Instituti i Dialogut dhe Komunikimit, 2011)
- Alexis de Tocqueville, *Demokracia në Amerikë* (Fondacioni Sopros e Kristalina, 2002)

#### **Literatura plotësuese:**

- L. Mayer, *Politikat krahasuese. Kombet e teoritë në një botë që ndryshon* , Tiranë, ORA, 2003
- L. Poliakov, *Totalitarizmat e shek. XX*, Tiranë, ORA, 1999
- B. Crick, *Në mbrojtje të politikës*, Tiranë, OMSCA, 1998
- Llambro Filo, *Sistemet Politike Bashkëkohore (Institucionet, Historia, Zhvillimet)*, Ideart, 2008
- Llambro Filo, *Historia e Shtetit të Mirëqenies Sociale*, EXTRA, 2007
- D. Held, *Models of Democracy II edition*, Cambridge, Polikty Press, 1988, f. 51-79
- G. Sartori, « Concept Misformation in Comparative Politics" *The American Political Science Review*: Vol. LXIV, no. 4

